e duhet të kryhen nga koncensionari janë ne
tëdhjetë e nëntë milion e shtatë qind e
dy) lekë (meTVSH), sipas preventivit
76.596.000 (njëqind e shtatë injetë e gjashtë
të investohen n[illegible]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GENTJANA BRATI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.7, RRUGA GJERGJ FISHTA,
GODINA NR.9, AP. NR. 1, HYRJA NR.1
TEL: 0682032619

KONTRATË KONCESIONI

Nr. repertori: 945 **Nr. koleksioni: 282**

Tirane më 01/04/2022

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

A2022053840030314560

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 945 Rep.
NR. 282 Kol.

A20220538400303145G0

KONTRATË SHTESË KONCESIONI
PËR
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT NR.2393 REP., NR.1219 KOL., DATË 24.05.2010 TË FORMËS "BOT" (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "TOPÇIAS"

Në Tiranë, më datë 01, muaji Prill, viti 2022 (dymijë e njëzetë e dy), para meje noter Genjona Braha, anëtar i dhomës së Noterisë TIRANE, me adresë Tiranë, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.9111 Prot., datë 17.12.2021, datë (kopje bashkëlidhur) nga Z. Ilir Bejtja, i datëlindjes 17.01.1966, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Leternjoftim Nr.ID dhe Nr.personal

DHE

Shoqërisë Koncesionare "Hydro Energji Transformer Topçias-El" sh.p.k., themeluar si person juridik datë 02.06.2010 dhe rregjistruar në QKB datë 10.06.2010, me NUIS L03010201S, i përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Z. Bujar Nurka, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta Nr._____

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim), me Nr. 2393 Rep, Nr. 1219 Kol, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritetit Kontraktues) dhe bashkimit të shoqërive "Dieta" sh.p.k dhe "Rati" sh.p.k (Koncesionari) për ndërtimin e HEC "Topçias", nënshkruar nga palët dhe hyrë në fuqi datë 24.05.2010.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe bashkimi të përkohshëm të shoqërive "Dieta" sh.p.k dhe "Rati" sh.p.k (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit HEC "Topçias", Nr. 2393 Rep, Nr. 1219 Kol, datë 24 05 2010 (në vijim referuar si "Kontrata e Koncesionit");

- Referuar Vendimit Nr. 1643, datë 15.06.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit për "Ndryshimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe pranimin e padisë konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim për zgjidhjen e kontratës së koncesionit Nr. 4222/6 Prot, datë 27.06.2012".

- Shkresës së Autoritetit Kontraktues (MIE) me Nr. 7319/4 Prot. datë 10.03.2017 "Kthim përgjigje", me anë të së cilës i bën me dije shoqërisë koncesionare "Hydro Energji Transformer" sh.p.k. se kontrata e koncensionit Nr. 2393 Rep, Nr. 1219 Kol, datë 24 05 2010 për ndërtimin e HEC-it "Topçias" është në fuqi bazuar në Vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Nr. 1643, datë 15.06.2016 dhe në përmbushje të detyrimeve që kontrata e koncesionit përcakton MIE i ka kërkuar shoqërisë koncensionare paraqitjen e Formularit të Sigurimit të Kontratës dhe projektit të zbatimit për ndërtimin e hidrocentralit "Topçias".

- Projektit të zbatimit të riparaqitur nga shoqëria koncesionare "Hydro Energji Transformer Topçias-El" sh.p.k., me shkresë prot i MIE-s Nr. 7319/6, datë 06.10.2017 dhe konkluzionit përfundimtar të Oponencës Teknike të AKBN me shkresë Nr. 2388/6 Prot, datë 18.07.2018, protokolluar në MIE me Nr.10047 Prot., datë 18.07.2018 ku përcaktohet se " Projekti i zbatimit respekton kufijtë e sipërm dhe të poshtëm të kontratës koncesionare, pra objekti shtrihet brenda kufijve koncesionare dhe ku rekomandohet që, ndryshimi i vlerave të parametrave hidroenergjetikë të projektit të zbatimit të vlerësuar nga Oponenca Teknike. të pasqyrohen në Kontratën Shtesë të Koncesionit gjatë miratimit nga MIE".

- Shkresës së MIE Nr. 10047/1 Prot., datë 15.10.2018 "Miratohet projekti i zbatimit i hidrocentralit"Topçias", me anë të së cilës Autoriteti Kontraktues miraton projektin e zbatimit për ndërtimin e hidrocentralit Topçias, me vendodhje në kanalin vaditës ekzistues Hajdaraj Topçias (Naum Panxhi), Elbasan dhe shprehet i gatshëm për të nënshkruar kontratën shtesë të koncesionit ku do të pasqyrohen ndryshimet e parametrave hidroenergjetikë, në përputhje me projektin e zbatimit të ripunuar, pas paraqitjes të preventivit përmbledhës 4 (katër) kopje dhe formularit të sigurimit të kontratës për vlerën e investimit sipas projektit të zbatimit.

- Shkresës prot i MIE s Nr. 8006 , datë 13.11.2020, së shoqërisë koncesionare "Hydro Energji Transformer Topçias-El" sh.p.k. me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të programit të punimeve për ndërtimin e HEC "Topçias" referuar periudhës së ndërprerjes së aktivitetit të shoqërisë nga momenti i shkresës së Autoritetit Kontraktues Nr.4222/6 Prot datë 27.06.2012 "Njoftim për zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit" deri në momentin e Vendimit Nr. 1463 datë 15.06.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit për konstatimin e pavleshmërisë absolute të aktit adminsitrativ të Autoritetit Kontraktues Nr.4222/6 Prot datë 27.06.2012.

- Mbështetur në nenin 28 "Ndryshime" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje te shkruar të dy palëve; si dhe

- Në nenin 29 "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari zotohen të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

Në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" me Nr. 2393 Rep, Nr. 1219 Kol, për ndërtimin e HEC "Topçias", nënshkruar nga palët dhe hyrë në fuqi datë 24.05.2010, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 1 "Përkufizime dhe interpretime",

në pikën 1.5, shprehja: "...me fuqi të instaluar 1,850 (njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) kWh ....", zëvendësohen me shprehjen: "……me fuqi totale të instaluar 4,089 (katërmijë e tetëdhjetë e nëntë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 18 947 553 (tetëmbëdhjë milion nëntëqindedyzetë e shtatëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) kWh ....".

Neni 2

Neni 3, "Karakteristikat e hidrocentraleve", ndryshohet si më poshtë:

Pika 3.1 Hidrocentrali "Topçias" do të ndërtohen duke shfrytëzuar kanalin vaditës ekzistues Hajdaraj Topçias (Naun Panxhi) Elbasan, me këto karakteristika:

- Kuotat e veprave:
  - Vepra e marrjes 108.50 m.n.n.d.
  - Godina e centralit 92.00 m.n.n.d.
- Fuqia e instaluar N= 4089 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike E= 18,947.553 kWh/vit

Neni 3

Në nenin 8 "Detyrimet e koncesionarit", në pikën 8.4, shprehja "Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës", zëvendësohet me shprehjen "Të zbatojë preventivin e miratuar dhe vulor nga AKBN sipas Aneksit 1 bashkëlidhur shtesës së kontratës".

Në nenin 8 "Detyrimet e koncesionarit", në pikën 8.6, shprehja "....me fuqi totale të vendosur ne sasinë jo më pak se 1,850 kW", zëvendësohet me shprehjen "....me fuqi totale të vendosur ne sasinë jo më pak se 4,089 kW (katërmijë e tetëdhjetë e nëntë) kW".

Neni 4

Në neni 9 "Vlerësimi i investimeve" në pikën 9.1 bëhet ndryshimi si më poshtë;

A20220538403030314560

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncensionari janë në vlerën totale prej 989755202 lekë (nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e shtatë qind e pesëdhjetë e pesëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë (meTVSH), sipas preventivit bashkëlidhur kësaj kontrate shtesë, nga të cilat 176,596,000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion epesëqindenëntëdhjetëgjashtëmijë) lekë do të investohen në makineri e pajisje.

Neni 5

Në nenin 10 "Programi i punimeve" pika 10.2 ndryshohet si më poshtë;

Koncesionari merr përsipër të vërë në shfrytëzim hidrocentralin brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës shtesë të koncesionit.

Neni 6

Në nenin 14 "Sigurimi i kontratës", në pikën 14.1, shprehja "..një shumë prej 12,822,100 (dymbëdhjetëmilion e tetëqindenjëzetedy mijë e njëqind) leke...", zëvendësohet me shprehjen ".....një shumë prej 98 975 526.2 (nëntëdhjetë e tetëmilion e nëntëqindenshtatëdhjetëe pesëmijë e pesëqindenjëzetë e gjashtë) lekë.

Neni 7

Në nenin 23 "Sanksionet", në pikën 23.2, gërma i, shprehja "...në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 15 000, 000 kWh/vit, Autoriteti Kontraktues do ta marrë të plotë tarifën koncesionare prej 2 % (për sasi prej 300,000 kWh/vit) zëvendësohet me shprehjen, në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 18 947 533 kWh/vit , Autoriteti Kontraktues do ta marrë të plotë tarifën koncesionare prej 2 % (për sasi prej 378,956.66 kWh/vit).

Neni 8

Kontrata Shtesë e koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES	**SHOQËRIA KONCESIONARE**
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	**"Hydro Energji Transformer Topçias-El" sh.p.k**

Përfaqësuar me Autorizim Nr. 9111 Prot, datë 17.12.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Industrise nga:

Z. Ilir Bejtja

Përfaqësuar.nga:

Z. Bujar Nurka

Fq. 1

Energji Transformer Hydro Topçias-EL L03019201S